Mesazh nga z-nja Odri Azulle
drejtoreshë e përgjithshme e UNESKO,
me rastin e Ditës Botërore të Ujit
22 mars viti 2022

Në ciklin global të ujit, ujërat nëntokësore janë thelbësore, por shpesh anashkalohen. Ky thesar i fshehur zë 99% të totalit të ujit të ëmbël të lëngshëm në Tokë. Ato jo vetëm që janë thelbësore për të gjithë botën e gjallë, por gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në ekosistem.

Në fakt, 49% e ujit që përdoret në amvisëri dhe reth 25% e ujit për vaditje vijnë nga ujërat nëntokësor. Pothuajse 50% nga populli urban botëror varen nga burimet nëntokësore të ujit.Ujësjellësit gjithashtu janë të lidhura me lumenjt,liqenet dhe moçalet

Me përshtatjen e planetit ndaj ndryshimeve klimatike dhe rritjes së popullsisë, ujërat nëntokësore po luajnë një rol të madh në plotësimin e nevojës në rritje për ushqim dhe ujë të pijshëm. Megjithatë, ky burim themelor përballet gjithashtu me rreziqe serioze - ndër të cilat, joadekuate mbrojtje dhe nganjëherë ndotje e pakthyeshme.

Prandaj, në Ditën Botërore të Ujit, UNESCO feston këtë burim thelbësor - sepse

Mbrojtja më e mirë dhe menaxhimi i ujërave nëntokësore janë përgjegjësia jonë e përbashkët dhe e interes i jonë i perbashket.

UNESKO ka punuar për një kohë të gjatë për të arritur këtë qëllim, veçanërisht përmes arsimit,ndërtimin e kapaciteteve dhe mbledhja e të dhënave. Me Familjen tonë të Ujit, ne fituam përvojë të gjerë në trajnimin e popullatës dhe sigurimin e njohurive solide në ndjenjën e vendimmarrjes efektive dhe të qëndrueshme për ujërat nëntokësorë.

Ne mbështesim edukimin e shteteve për rëndësinë e ujit dhe themelimin e kapaciteteve për menaxhim më të mirë të ujit - jo vetëm përmes programit tonë Ndërqeveritarë për Hidrologji dhe programin e Vlerësimit të Ujit në mbarë botën, por edhe nëpërmjet institucioneve partnerë shkencorë, duke përfshirë qendrat dhe universitetet e kategorisë II të UNESKO katedra e ujit.

Këtë vit, me botimin e fundit të Raportit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Ujit e cila do të dalë në Ditën Botërore të Ujit, ne po fokusohemi në ujërat nëntokësore,duke theksuar rolin e tyre, përfitimet, sfidat dhe mundësitë e tyre.

Në një botë ku kërkesa po rritet dhe burimet ujore po pakësohen, të gjithë kanë nevojë për t'u ndërgjegjësuar për vlerën e ujërave nëntokësore, dhe UNESKO mbetet plotësisht i angazhuar për këtë qëllim.